



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr 115 Prot

Pogradec më 10.01 2024

SHPLLJE PËR POZICION TE LIRË PUNE NË BASHKINË POGRADEC

Në kuadër të projektit “*Shërbime të integruara shëndetësore dhe sociale për individët me problematika të lëvizshmërisë*”, Bashkia Pogradec shpall njoftimin për 1(një) pozicion të lirë pune “Fizioterapist”.

Qëllimi i Vendit të Punës

Fizioterapisti në këtë vend pune është përgjegjës për dhënien e shërbimeve fizioterapeutike për persona me aftësi të kufizuara para dhe tetraplegjik

Detyrat dhe Përgjegjësitë

- **Të vlerësojë** nevojat dhe **të përcaktojë** masat dhe veprimet për përmirësimin e parametrave fizikë e psikikë të personave me PAK,
- **Të kryejë** terapi për riaftësimin e gjymtyrëve, nëpërmjet ushtrimeve fizike të cilët forcojnë ekuilibrin e personave me PAK
- **Fizioterapisti** do të operojë në disa Njesi Administrative të Bashkisë Pogradec, nëpërmjet shërbimeve të lëvizshme për komunitetet e largëta dhe të pafavorizuara.
- **Të ofrojë** shërbimin e fizioterapisë në Qendrën e Fizioterapisë dhe në Qendrën Komunitare, për të gjithë qytetarët sipas planit nëpunës dhe nevojave të identifikuar, shërbim në familje sipas nevojave.
- **Të ndihmojë** fëmijët me autizëm që kanë vështirësi në koordinim , balancë apo planifikim të lëvizjes kundrejt ambientit si dhe pjesëmarrjen në lojra dhe aktivitete rikrijuese,
- **Të përqendrojë** punën në zhvillimin e aftësive motorike të mëdha (lëvizje që përfshijnë muskujt e duarve e të këmbëve)
- **Të përgatitë** dhe **të vlerësojë** periodikisht progresin për sjelljen, autonominë, komunikimin etj.

Kualifikimet dhe Cilësitë e Punonjësit

1. Diplomë e nivelit “Bachelor” ose “Master” në Fizioterapi
2. Të ketë përvojë në profesion.

¹ Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

3. I aftë fizikisht dhe teknikisht të përshtasë trajtimin fizioterapeutik në mjedise/rrethana të vështira e me hapësira të vogla
4. Gëzon integritet individual dhe profesional si dhe pjekuri emocionale
5. Aftësi të mira planifikuese dhe organizative, negociuese dhe në zgjidhjen e konfliktit
6. Aftësi të mira interpersonale e i aftë të punojë me grupe të ndryshme njerëzish në mënyrë profesionale dhe etike

Afatet dhe Paraqitja e Dokumenteve të Konkurrentëve

Dokumente që do të dorëzohen në mënyrë zyrtare në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbeshtetëse.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve është data 23.01.2024

Dokumentet që do të paraqiten janë :

- a) Kërkesë personale për pozicionin e vendit të punës ;
- b) CV(curriculum vitae);
- c) Diplomë e nivelit master ne degën Fizioterapi (fotokopje e noterizuar)
- d) Dëshmi penaliteti e leshuar nga Ministria e Drejtësisë ,e cila duhet nxjerre jo më parë se 3 muaj nga data e zhvillimit të testimit;
- e) Certifikatë e njohurive bazë për përdorimin e kompjuterit;
- f) Fotokopje e letërnjoftimit;
- g) Fotokopje e librezës punës, nëse ka qenë në marëdhënie pune

Mungesa e njërit prej dokumenteve të mësipërme apo pavlefshmëria e dokumenteve sjell skualifikimin e konkurrentit.

PËRGJEGJËS I BURIMEVE NJERËZORE

LAURA ELMASLLARI

